FRAUEN*STREIK

NOW

Bashkëvepro dhe informohu!

Ne e kemi një faqe interneti (Uebfaqe) në gjuhën gjermane, frenge dhe italiane. Në të mund të gjesh edhe informata të tjera, se si mund të bashkëveprosh apo si mund të solidarizohesh.

Frau-streikt.ch — Greve-des-femmes.ch
Sciopero-delle-donne.ch

GREVA E GRAVE

14 Qershor 2019

UNIA

Ne duam...

Respekt!

... Respekt për punën tonë dhe mundësi të barabarta.
... Zero-tolerancë kundër seksizmit dhe ngacmimit seksual ndaj grave.
... Jo dhunë ndaj grave.

Pagë më e madhe!

... Pagë të barabartë për punë të njëjtë dhe të barasvlershme.
... Paga të dinjitetshme, nga të cilat ne mund të jetojmë!
... Pensione për një jetë të dinjitetshme në pleqëri.

Më shumë kohë!

... Pajtueshmëri më e mirë midis profesionit dhe jetës private.
... Kohë për ngritjen e mëtutjeshme dhe perspektivë profesionale.
... Përqindje të garantuar punësimi, nga i cili mund të jetojmë.

Pse të bëjmë greva?

Barazia është duke u zvarritur me tempo kërmilli. Diskriminimi në paga vazhdon të jetë i madh, pajtueshmëria midis profesionit dhe jetës private përballet me pengesa dhe të drejtat e grave në gjithë botën vazhdojnë të jenë nën presion nga politikanët reaksionarë. Kjo i zemëron me të drejtë gratë në Zvicër. Ato, më 14 Qershor, do të marrin pjesë në grevën e grave dhe në ditën e aksionit.

Si mund të marr pjesë unë në grevën e grave?

Ti mundesh...

... Të bësh grevë më 14 Qershor, vetëm (psh. të bësh një pauzë dreke të zgjatur).
... Të marrësh pjesë në tubimet rajonale të grevave apo në demonstratat me 14 Qershor.
... Me kolege/ët e tu të diskutosh në lidhje me grevën e grave dhe të organizosh një aksion të përbashkët në ndërmarrjen tënde.
... Të drejtohesh në sindikatën tënde Unia, e cila do të të ofrojë informata tjera, se çfarë mund të bësh ti.

Gratë nuk lejojnë më që të tërhiqen për hunde!